

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHEKRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje elektronike për nevoja të Klubit Sportiv Studenti”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pajisje elektronike
31710000-6

VLERA E FONDIT LIMIT: **1.083.333 (një milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*

2.2.2 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare përkatësisht (2019, 2020, 2021) në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet përkatësisht 433.333 (katërqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;". Kjo procedurë është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat

ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3(tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.*

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapacitetet teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së perlllogaritur të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të

shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Faturat duhet të jenë të nënshkruara nga Blerësi dhe Shitësi.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, nga ana e operatorit ekonomik ofertues duhet të provohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: *Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.*

Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi

të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015 (ose e përditësuar)** në fushën e menaxhimit të cilësisë, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit (e vlefshme);
- **ISO 27001:2013 (ose e përditësuar)** (Sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit) objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit (e vlefshme);

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë

procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si çertifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

Argumentimi: ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- *mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.*
- *aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.*
- *aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.*
- *aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambjente sensitive.*

Pajisjet objekt prokurimi kanë periudhë garancie konform specifikimeve referuar shtojces 5 përgjatë së cilës operatori ekonomik do të mbajë edhe përgjegjësi dhe do të ofrojë suportin përgjatë periudhës së garancisë. ISO 27001 i operatorit ekonomik është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor për aplikimin e praktikave mbi menaxhimin e risqeve, trajtimin e të dhënave dhe shërbimeve që do të kryhen në rast defekti të këtyre pajisjeve.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose broshura për mallrat që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të cdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre).

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton.*

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë në të cilën të deklarojë se mallrat objekt i procedurës do të transportohen prej tij në mjediset e Autoritetit Kontraktor përfitues.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë në të cilën të deklarojë se mallrat objekt i procedurës do të instalohen dhe konfigurohen prej tij dhe që kanë një afat garancie sipas garancisë së përcaktuar në specifikimet teknike të mallrave përkatës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga nje Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin dhe tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalentii tij/saj”.

1. Laptop Basic

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	4500 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	8 GB, DDR4 min. 2133 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	500 GB HDD, 7200 RPM SATA
“Graphics”:	Integrated Graphics with 1 GB Video Memory
“Media Device”:	DVD+/-RW with DL Internal ose External; Memory card reader
Ekrani “Display”:	15.6” LED HD (1366 x 768), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 45 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0 (1) DisplayPort/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11 ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n); Bluetooth min. V4.0
“Sound”:	Integrated , (2) x built-in speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	QWERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European

Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”:	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për “Laptop” janë marrë nga “Specifikimet Teknike Standarde për vitin 2022” të publikuara nga Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit konkretisht në Modelin Laptop Basic.

2. Laptop Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	17000 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	16 GB, min. DDR4 2666 MHz
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	≥ 500 GB SSD
“Graphics”:	Dedicated Graphics with min. 4 GB Memory
“Media Device”:	DVD+/-RW DL Internal ose External e të njëjtës Markë me Laptop-in; Memory Card Reader
Ekрани “Display”:	15.6" FHD LED (1920 x 1080), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 60Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (3) USB 3.0/USB 3.1 (1) DP/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n); Bluetooth min. V4.1
“Sound”:	Integrated , (2) x built-in speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional

Tastiera “Keyboard”:	QWERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”:	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për “Laptop” janë marrë nga “Specifikimet Teknike Standarde për vitin 2022” të publikuara nga Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit konkretisht në Modelin Laptop Advanced. I vetmi komponent i cili bën prejashtim është **“Pikët Min. për Procesorin”**, ku janë kërkuar 17000 pikë për arsye të performancës dhe shpejtësisë më të mirë të procesimit (e rekomanduar në specifikimet standarte të AKSHIT).

3. Fotokopje Multifunction B&W Basic.

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier/Printer
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4”:	≥ 20 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	≥ 5 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser B&W
Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:	25%-200%
Vendosja e Dokumentit “Document Feeder”:	ADF
Sirtarët për Letrën “Paper Trays”:	1
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min”:	250 Fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min Standard”:	100 Fletë
Kopjim/Printim në të dy Faqet “Duplex Copying/Print.”:	Nuk Specifikohet
Formati i Letrës “Media Sizes”:	A4
Memorja “Memory”:	≥ 128 MB
“Hard Disk”:	Nuk Specifikohet
Shpejtësia e Skanimit “Scan Speed”:	Nuk Specifikohet

Rezolucioni i Skanimit “Scan Resolution”:	Nuk Specifikohet
Formati i Skanimit Maksimal “Maximum Scan Size”:	Nuk Specifikohet
“Toner”:	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit “Interface”:	High Speed USB 2.0
“Ethernet”:	Po
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Software/Drivers CD :	Po
Kabëll USB:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit ose 15 000 Kopje*
*Kush të arrihet më parë	
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për “Fotokopje multifunkionale B&W Basic ” janë marrë nga “Specifikimet Teknike Standarde për vitin 2022” të publikuara nga Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit konkretisht në Modelin Fotokopje Multifunkionale Color MFP Basic.

4. Fotokopje Multifunction Color Basic

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier/Printer
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4”:	≥ 20 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	≥ 30 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser Color/ B&W
Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:	25%-400%
Vendosja e Dokumentit “Document Feeder”:	ADF
Sirtarët për Letrën “Paper Trays”:	min1
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min”:	150 Fletë (jo Bypass)
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min Standard”:	100 Fletë
Kopjim/Printim në të dy Faqet “Duplex Copying/Print.”:	Nuk Specifikohet
Formati i Letrës “Media Sizes”:	A4
Memorja “Memory”:	≥ 256 MB
“Hard Disk”:	Nuk Specifikohet
Shpejtësia e Skanimit “Scan Speed”:	Nuk Specifikohet

Rezolucioni i Skanimit “Scan Resolution”:	600 dpi
Formati i Skanimit Maksimal “Maximum Scan Size”:	Nuk Specifikohet
“Toner”:	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit “Interface”:	High Speed USB 2.0
“Ethernet”:	Po
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Software/Drivers CD :	Po
Kabëll USB:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit ose 90 000 Kopje*
*Kush të arrihet më parë	
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për “Fotokopje multifunkionale Color Basic” janë marrë nga “Specifikimet Teknike Standarde për vitin 2022” të publikuara nga Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit konkretisht në Modelin Fotokopje Multifunkionale Color MFP Basic. *Kërkesat janë në përputhje me nenin 36 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 25.11.2022, ora 12:00.